



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 40 të Statutit të Komunës së Prishtinës, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 18.07.2003 merr:

V E N D I M
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORËS MBI
TARIFAT DHE NGARKESAT KOMUNALE
01. nr. 413- 523 e dates 02.04.2002

I

Ndryshohet dhe plotësohet Rregullorja për tarifa dhe ngarkesa komunale
01. nr. 413- 523 e dates 02.04.2002 dhe atë:

LICENCË NË BIZNES

PIKA O2.0 - Ndryshohet dhe thotë:

02.1.1 Për liçencimin e firmës për subjektet afariste caktohet tarifa për veprimtaritë:

65.11 Bankat dhe Agjencioni Financiar si dhe Shoqëritë aksionare, Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar për transaksione,

64.11 Veprimtaritë e komunikimit postal dhe telefonik si dhe shërbimet postale-telefonike private,

92.71 Llotaritë dhe lojrat e fatit

51.20, 51.40, 51.50, 51.60, 51.70, (sintetika), tregtia me shumicë dhe përfaqësitë e tyre (përpos tregtisë së mallrave ushqimore),

92.52 Tregtia komisionare,

51.46 Tregtia dhe qarkullimi i barërave me shumicë,

55.30 Ndërmarrjet e shërbimeve hoteliere,

63.40 Ndërmarrjet dhe agjencitë që merren me ndërmjetësime doganore, transport dhe shpedicion.

92.33 Organizim i panairove,ekspozitave dhe kompanitë e jashtme

66.03 Kompanitë, të cilat miren me sigurimin e pasurisë dhe personave. Njësitë afariste sipas tarifës,

02.2.20 paguajnë 30 % nga tarifa bazë.

Tarifa vjetore.....1000 Euro

02.1.2.

52.46 Tregtia dhe qarkullimi i barërave me pakicë,

60.22 Komunikacioni rrugor (përpos komunikacionit të qytetit),

62.10 Komunikacioni ajror,

63.30 Agjencitë turistike,
70.31 Subjektet të cilat merren me ndërmjetësimin në transaksionet e pasurive të palujtshme,
74.20 Ndërmarrjet projektuese- profesionale dhe agjencionet Connsalting,
92.11 Ndërmarrjet për blerjen dhe distribuimin e filmave,
52.41 Tregtia me pakicë e mallit jo ushqimor,
55.30 Restorantet,
55.40 Kafiteritë
02.01 Pylltaria, njësia afariste e ndërmarrjeve sipas tarifës 02.0 paguajnë 30% nga Tarifa bazë.

Tarifa vjetore..... 500 Euro

02.1.3

45.21, 45.33 Subjektet si :Ndërtimtaria, ujësjells, tregtia e prodhimeve ushqimore-bujqësore dhe prodhimtaria e prodhimeve nga brumi.

Tarifa vjetore.....250 Euro

02.1.4 Lejet profesionale si:Mjekët, stomatologët, avokatet dhe shërbimet profesionale

Tarifa vjetore.....150 Euro

02.1.5 Sport dhe rekreacion.

Tarifa vjetore.....50 Euro

02.1.6 Lokalet e pavarura zejtare si dhe produksionet muzikore për shumëzimin dhe shitjen e audio- video kasetave dhe CD-ve.

Tarifa vjetore.....75 Euro

02.1.7. Subjektet tjera që nuk janë përfshirë në pikat paraprake.....75 Euro

Vërejtje: Nëse licencimi i firmës bëhet në gjashtëmujorin e parë të vitit kalendarik paguhet ngarkesa për tërë vitin. Nëse licencimi i firmës bëhet në gjashtëmujorin e dytë ngarkesa për atë vit paguhet 50%.

02.1.7.1 Për dhëniën e lejës për punë të lokalit afarist.....12.5 Euro

Vërejtje:Tarifa paguhet me rastin e paraqitjes së kërkesës.

II

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

Nr _____ Dt _____

**KRYETARI
Ismet Beqiri**